

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Qershor 2024

24.07.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin qershor 2024.

Rritet skema për Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës në muajin qershor 2024, krahasuar me qershor 2023

Në muajin qershor 2024, nga Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë përfituar 847 persona, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (që ishin 735 përfitues), vërehet një rritje prej 15,2%.

Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

	Muaji/Viti		6.2024/ 06/2023
	06/2023	06/2024	
Skema e ndihmës sociale	21,131	19,239	-9.0
Pensionet bazike të moshës	148,111	149,504	0.9
Pensionet kontributpaguese të moshës	48,937	48,314	-1.3
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	18,675	20,239	8.4
Pensionet e Trepçës	1,528	1,239	-18.9
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	735	847	15.2
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1,303	1,346	3.3
Skema e të verbërve	1,836	1,849	0.7
Pensionet Familjare	3,068	2,878	-6.2
Pensionet e Invalidëve të punës	51	42	-17.6
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	2,655	3,021	13.8
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	13,223	13,978	5.7
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	12,972	12,845	-1.0
Veteranët	36,830	37,103	0.7
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	3,228	3,584	11.0

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin qershor 2024, krahasuar me muajin qershor 2023, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet e Trepçës (-18,9%); skema për pensionet invalidore (-17,6%); skema e ndihmës sociale (-9,0%); skema për pensionet familjare (-6,2%); skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës (-1,3%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,0%).

Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin qershor 2024, krahasuar me muajin qershor 2023 kishte rritje të numrit të përfituesve nga: Skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike (13,8%); Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (11,0); Skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (8,4%); Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,7%); Skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,3%); Skema e pensioneve bazike të moshës (0,9%); Skema për veteranët e luftës (0,7%); Skema e kompensimeve për personat e verbër (0,7%);

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin qershor 2024, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare>